

RELACION TEKNIK


• Te pergjithshme

Bazuar ne detyren e projektimit te dhena nga Bashkia Shkoder per objektin "Sistemim-Asfaltim i rrugës "Muriqan-Goricë", nga ana jone si shoqeri projektimi filloi menjehere pune per hartimin e projekt-zbatimit.

Kjo rruge ndodhet ne jug-perendim te qytetit te Shkodrës, ne te Majte te rruges nacionale Shkodër-Muriqan, pas fshatit Muriqan.

Rruga ka nje gjatesi totale prej 2 216 ml. Fillimi i rruges eshte ne kryqezimin me rrugen kombetare Shkodër-Muriqan ne kuote absolute rreth 6.7 m dhe perfundon ne kuoten 12.3 m.

Ndertimi i ketij segmenti rrugor do te lehtesoje ne menyre te ndjeshme levizjen e banoreve te fshatit Goricë.



Horografia

Bashkia Shkoder ka kerkuar qe Projekti i Zbatimit Perfundimtar te ndahet ne dy faza, ne Fazen e Pare te perfshihen ato segmente rrugore me gjatesi te reduktuara te cilat jane brenda vleres se parashikuar ne Buxhetin e Bashkise Shkoder brenda vitit 2019, ndersa ne Fazen e Dyte te perfshihet pjesa tjeter e segmenteve rrugore qe tejkalon Buxhetin e Bashkise Shkoder per vitin 2019.

Per segmentet qe nuk financohet ne buxhetin e 2019, nga ana e Bashkise Shkoder do te shikohet mundesia e financimit te tyre ne nje faze tjeter.

- **Pershkrimi i Gjendjes se Trasese Ekzistuese**

Segmenti rrugor ku do të ndërtohet rruga nga km 1+020 kalon permes ndërtimeve 1-2 katëshe në zonën e Njësisë Administrative Goricë.

Pothuajse gjate te gjithë gjatesise rruga ka nje gjeresi konstante 5m deri ne km 2+000 dhe 3m ne vijim. Gjendja ekzistuese e trupit te rruges eshte ne kushte relativisht te keqija, me shtresa rrugore te degraduara, pergjithesisht me nje mbulese cakelli ose zhavorri.

Kanalet anesore te rruges pothuajse jane zhdukur me kalimin e viteve si rezultat i mungeses se mirembajtjes se duhur, gje e cila e ben te pamundur drenazhimin e ujrave sipërfaqesore duke ndikuar edhe me shume ne demtimin e trupit te rruges.

Gjate hartimit te ketij projekti eshte menduar qe ne masen me te madhe te mundshme te shfrytezohet traseja ekzistuese, ne kete menyre nuk do te krijonim probleme me shpronесimet ne rrugen e fshatit Goricë.

Kjo rruge perfaqeson nje trase te deformuar si dhe vepra arti pothuajse jashte funksioni, te cilat nuk sigurojne mbrojtjen e trasese, duke mos krijuar mundesine e drenimit te ujrave sipërfaqesore.

Traseja e segmentit Goricë nderpret kanale kullues prandaj dhe eshte parashikuar ndertimi i tombinove te reja me diameter 800 mm dhe 1000mm si dhe pastrimi e riprofilimi i kanaleve ekzistues. Gjthashtu eshte parashikuar ndertimi i nje tombinoje te re Box 1.5x1.5 ne pozicionin e nje tombinoje ekzistuese qe ka dale nga funksioni.

Ne kete segment do te kryehen punime asfaltike, do te ndertohen tombino dhe do parashikohen ndertimi i dy bankinave ne anët e saj. Bankinat, do të shërbejnë si distance sigurie mes korsisë së lëvizjes dhe kanaleve anësore.

Rruga përgjatë gjithë gjatësisë së saj do ketë pjerrësi tërthore gjë e cila mundëson drenazhimin e ujrave sipërfaqësore direkt aty ku ka kanale anësore ekzistuese.




Foto te gjendjes ekzistuese

• Pershkrimi i Projekt-Zbatimit

Ashtu sic u permend edhe me siper ne zonat e banuara eshte parashikuar qe aksi i rruges se re te vendoset mbi aksin e rruges ekzistuese, nje zgjidhje e tille eshte dhene per te mos krijuar probleme me shpronsimet e tokave. Si rrjedhoje edhe per rrezet e kthesave pergjithsisht jane aplikuar ato ekzistueset, por megjithate ne disa raste vec shfrytezimit te trasese ekzistuese eshte nderhyre edhe per permiresimin e rrezeve te kthesave.

Kjo rruge pergjate pjeses me te madhe te saj ka pjerresi te vogla mesatarisht midis 0.05-4.5%.

Segmenti i vetem me pjerresi rreth 9.4% eshte ne pjesen fundore te rruges km 2+190 deri km 2+216.

Pothuajse ne te gjitha gjatesine e rruges per shkak te shtresave ekzistuese te demtuara eshte parashikuar nje germim kasonete mesatarisht nga 30-60cm.

Ne projekt-zbatimin e ketij objekti eshte parashikuar nje rikonstruksion total i trupit te rruges ne te gjitha gjatesine e saj.

Gjeresia totale e trupit te rruges eshte 3-5m, me gjeresi asfalti 2.5-4m dhe bankina stabilizanti 2x0.5m. Ne zonen e banuar nga km 2+000 jane parshikuar bordura dhe nje shtrese betoni 0.25-0.5m me trashesi 10cm ne formen e kunetes.

Per shkak te gjeresise si dhe te fluksit te trafikut nga ana jone eshte parashikuar qe rruga te kete dy gjeresi te ndryshme pergjate te gjitha gjatesise se saj.

Nga km 0+000 deri km1+640 gjeresia totale e trupit te rruges eshte 5m, nga te cilat 4m gjeresi asfalti dhe dy bankina 0.5m me stabilizant.

Ne km 0+000 deri km 0+300 dhe km 0+720 deri km 1+010 per te shmangur fenomenin e permbytjes se rruges eshte parashikuar rritje e niveletes se rruges ekzistuese me nje lartesi mesatare 150cm.

Nga Km 1+640 - Km 2+000 eshte me gjeresi asfalti 3m ,bankina stabilizanti 0.5m, dhe kunete betoni 0.5m.

Nga Km 2+000 - Km 2+216 eshte me gjeresi asfalti 2.5m, kunete betoni 0.25m.

Pergjate rruges jane parashikuar pastrimi dhe riprofilimi i kanaleve kullues te dheut dhe ne nje rast edhe ndertimi i nje kanali betoni 0.5x0.5.

Prej Km 1+264 jane parshikuar te ndertohen mure prites buto-betoni me lartesi te ndryshme ($h=2.5$; 1.5 ; $1.0m$). Gjithashtu eshte parashikuar nje mur me $h=4m$ ne km 0+630 per mbrojtjen e ballit te ures ekzistuese.


Per sa i perket shtresave rrugore eshte parashikuar kjo pakete:

- 3 cm asfalto-beton
- 5 cm binder
- 20 cm stabilizant (0-31.5mm)
- 30 cm material shkembor (cakell/zhavorr)


Ne projekt eshte parashikuar trajtimi i te gjitha siperfaqeve te intersektimeve me rrugen kryesore ne gjatesi 5m per secilen. Kjo nderhyrje eshte e domosdoshme per te mbrojtur rrugen kryesore. Volumet per ndertimin e tyre jane parashikuar ne preventivin perkates.

Paketa e shtresave e parashikuar ne degezime eshte:

- 3 cm asfalto-beton
- 5 cm binder
- 20 cm stabilizant (0-31.5mm)
- 30 cm material shkembor (cakell/zhavorr)



Profile Tip



• Mbi Veprat e Artit

Si vepra arti ne kete studim do te konsiderojme tombinot rrethore, si edhe muret mbajtes betoni.

Tombinot qe jane parashikuar ne studim per largimin e ujrave siperfaqesore te vendosura ne zonat depresive te rruges do te jene me diameter Ø800mm dhe Ø1000mm sipas rastit me portal+portal. Gjithashtu eshte parashikuar zevendesimi i nje tombinoje ekzistuese me nje tombino box 1.5x1.5 me mure ne hyrje dhe dalje. Keto tombino do te sherbejne per kalimin e ujit te kanaleve kullues permes segmentit tone.

• Sinjalistika Rrugore

Persa i perket sinjalistikes rrugore nga ana jone eshte hartuar projekti i sinjalistikes vertikale dhe horizontale.

Me konkretisht ne te gjithe gjatesine e rruges jane parashikuar vendosje te tabelave trekendore 60cm, rrethore 40cm, katrore 60cm, dhe te drejtimit urban HxL=25x125.

Ne te gjitha degezimet jane vendosur tabela "STOP" me permasa (A=60, B=20, D=50).

Ne te dy anet e rruges eshte parashikuar vendosja e vizimit akrilik gjatesor me gjeresi 12cm.

Ne te gjitha degezimet eshte parashikuar qe tabela "STOP" te shoqerohet me nje shirit te vazhduar horizontal me gjeresi 0.5m, me qellim ndalimin e automjeteve qe te futen ne rrugen kryesore kur ata ndodhen ne brendesi te degezimit.

Megjithate bazuar edhe ne termat e references dhe mungeses se financimeve te nevojshme, nderhyrjet ne kete rruge jane minimale, per rrjedhoje ne te ardhmen mund te shikohet mundesia e nderhyrjeve me te plota.

Ashtu sic eshte permendur edhe me lart, ne perputhje me vendimin e Bashkise Shkoder, punimet ndertimore te parashikuara ne kete projekt-zbatimi jane ndare sipas fazave perkatese te financimit.

Me poshte pershkruhen punimet ndertimore qe do te realizohen sipas fazave perkatese te financimit.

• Faza e Pare

Gjate Fazes se Pare te Investimit me Vlere 18 143 073 me TVSH, perfshihen punimet rehabilituese ne km 0+000 deri km 0+320.

Ne km 0+000 deri km 0+320 do te kryhen te gjitha punimet e nevojshme, te cilat jane te nevojshme teknikisht, per nje operim sa me te mire te rruges.

Keto punime jane si me poshte vijon:

- Punime Germimi, km 0+000 deri km 0+320
- Punime Mbushje, km 0+000 deri km 0+320
- Punime Shtresash rrugore, km 0+000 deri km 0+320
- Punime per veprat e vogla te artit (kanale, tombino etj) km 0+000 deri km 0+320
- Punime Sinjalistike, ne km 0+000 deri km 0+320

- **Faza e Dyte**

Gjate Fazes se Dyte te Investimit me Vlere 56 708 705 me TVSH, perfshihen punimet rehabilituese ne km 0+320 deri km 2+216.

Ne km 0+320 deri km 2+216 do te kryhen te gjitha punimet e nevojshme, te cilat jane te nevojshme teknikisht, per nje operim sa me te mire te rruges.

Keto punime jane si me poshte vijon:

- Punime Germimi, km 0+320 deri km 2+216
- Punime Mbushje, km 0+320 deri km 2+216
- Punime Shtresash rrugore, km 0+320 deri km 2+216
- Punime per veprat e vogla te artit (kanale, tombino etj) km 0+320 deri km 2+216
- Punime Sinjalistike, km 0+320 deri km 2+216

Bashkangjitur ketij raporti jane te gjitha materialet teknike si me poshte vijon:

- Vizatimet dhe Detajet Teknike
- Preventivi (Preventivi Total, Preventivi Faza e Pare/ Preventivi Faza e Dyte)dhe Analizat e Cmimeve
- Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis VNM
- Specifikimet Teknike
- Grafiku i punimeve

Drejtuesi Ligjor

Ing. Redi Struga

